

SHKOLLA SHQIPE E MËSIMIT PLOTËSUES NË TURKU TË FINLANDËS

Shkolla Shqipe e Mësimi Plotësues në Turku të Finlandës ka filluar nga viti 1992 me ardhjen masive të azilkërkuesëve .Fillimisht nisem punën me dy grupe mësimore në javë.Me rritjen e numrit të bashkatdhetarëve me banim në këtë qytet numri i grupeve arriti në dhjetë ndërsa numri i nxënësve që vijojnë rregullisht dhe pjesërisht kaloi numërin 130. Nxënësit e shkollës shqipe të mësimi plotësues mësojnë shkrimleximin ,historinë kulturën e traditën e lavdishme të kombit tonë.Nxënësit e mësimi shqip janë njëkohësisht edhe kultivuesit e jetës kulturore të bashkatdhetarëve në mesin ku jetojmë.Ata janë pjesëmarrës në programet kulturoartistike të organizuara në prag të festive tona kombëtare me recitale,vallëzime,këngë shqipe.Shpesh ata ftohen të marrin pjesë edhe në programet e organizuara nga vendasit të prezentojnë vallet tona popullore. Në prag të festive kombëtare organizohen kuize diturie në temë nga gjuha dhe historia kombëtare . Grupi Letrar “ Albulena “ mbanë orë letrare duke ushtruar artin e shkrimit dhe recitimit artistik. Piktorët e vegjël çdo vit organizojnë sëpaku një ekspozitë të pikturave në temë aktuale. ,Aktivitet e përmendura kulturore të nxënësve kanë gjithëmonë mbeshtetjen materiale për shperblime dhe sherbime të tjera të Shoqatës Shqiptare “ Bashkimi “ në Turku .

Nexhmi Salihu